

## EMERGENCIES IN THE ENVIRONMENT

**Ibush Luzha**

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, [ibushluzha@hotmail.com](mailto:ibushluzha@hotmail.com)

**Xhelal Këpuska**

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, [xhelalkepuska@yahoo.com](mailto:xhelalkepuska@yahoo.com)

**Abstract:** Emergencies and the environment have many common concepts, issues, processes and concerns. Emergency management in the environment involves identifying and assessing risks, planning, responding and all essential activities in emergency management practice. Emergencies in the environment address issues such as water quality, protection of flora and fauna as well as overall ecosystem health. Emergencies in the environment can be defined as a disaster or unexpected accident resulting from natural, technological or man-made factors, or a combination thereof, that cause or threaten to cause severely environmental and human health and life. Prevents the consequences of natural hazards such as earthquakes, storms, floods, tsunamis, fires on earth, landslides and man-made disasters such as industrial accidents, transport accidents, chemical leaks, oil spills and a host of other types emergencies. The frequency and intensity of natural disasters over the last decades both in our country and in the world has been accompanied by significant damage to material goods but also to humans, and has increased significantly globally and regionally. This situation is exacerbated by environmental degradation, global warming and climate change. In many cases, natural disasters have turned into disasters due to low awareness and lack of community information.

**Keywords:** Emergencies, environment, global warming, disasters, natural disasters.

## EMERGJENCAT NË AMBIENT

**Ibush Luzha**

Kolegji “Biznesi” në Prishtinë, Kosovë, [ibushluzha@hotmail.com](mailto:ibushluzha@hotmail.com)

**Xhelal Këpuska**

Kolegji “Biznesi” në Prishtinë, Kosovë, [xhelalkepuska@yahoo.com](mailto:xhelalkepuska@yahoo.com)

**Përmbledhje:** Emergjencat dhe ambienti kanë shumë koncepte, çështje, procese dhe shqetësime të përbashkëta. Menaxhimi i emergjencave në ambient përfshinë identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, planifikimin, reagimin dhe të gjitha aktivitetet thelbësore në praktikën e menaxhimit të emergjencave. Emergjencat në ambient adresojnë çështje të tilla si cilësia e ujit, mbrojtja e florës dhe faunës si dhe shëndetin e përgjithshëm të ekosistemit.

Emergjencat në ambient mund të përcaktohen si një fatkeqësi ose aksident i papritur që vjen nga faktorë natyrorë, teknologjik ose të shkaktuar nga njeriu respektivisht një kombinim i këtyre, që shkaktojnë ose kërcënojnë për të shkaktuar dëme të rënda mjedisore si dhe dëme për shëndetin e njerëzve dhe jetën. Paraprinë pasojat nga rreziqet natyrore siç janë tërmetet, stuhitë, përmytjet, tsunamit, zjarret në tokë, rrëshqitjet e dheut dhe katastrofat e paraprirë nga njeriu si aksidentet industriale, aksidentet gjatë transportit, rrjedhjet kimike, derdhjet e naftës dhe një mori e llojeve të tjera të emergjencave.

Shpeshësia dhe intensiteti i fatkeqësive natyrore gjatë dekadave të fundit si te ne ashtu edhe në botë është përcjellë me dëme të mëdha në të mira materiale por edhe në njerëz, është rritur ndjeshëm në nivel global dhe rajonal. Kjo situatë është përkeqësuar akoma më shumë për shkak të degradimit të mjedisit, ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike. Në një pjesë të madhe të rasteve, fatkeqësitë natyrore janë shndërruar në katastrofa për shkak të shkallës së ulët të ndërgjegjësimit dhe mungesës së informacionit të komunitetit.

**Fjalë kyçe:** Emergjencat, ambienti, ngrohja globale, fatkeqësitë, fatkeqësitë natyrore.

### 1. HYRJE

Emergjencat në ambient janë pasoj e një fatkeqësie natyrore, konflikti ose aksidenti industrial, teknologjik, kur jeta dhe ekosistemi kërcënohen nga lirimi i substancave të rrezikshme, ose për shkak të dëmtimeve të ekosistemit. Si pasoj e ndryshimeve klimatike pritet rritje e numrit dhe shkallës së katastrofave natyrore dhe për këtë duhet të jemi të përgatitur për t’iu përgjigjur emergjencave gjithnjë e më të shumta mjedisore.

Edhe Kosova ku shpeshësia e emergjencave natyrore është domethënëse, nuk përbën përjashtim nga ky rregull. Përgatitja dhe edukimi për përballimin e fatkeqësive të ndryshme dhe menaxhimin e situatave emergjente në ambient është detyrë e çdo institucion arsimor, pavarësisht madhësisë dhe vendndodhjes së tij. Ne nuk jemi në

gjendje të parandalojmë dridhjet e tokës, stuhitë që fryjnë, ose shiun që bie, por përmes edukimit të vazhdueshëm dhe përgatitjes për rreziqet natyrore dhe ato të shkaktuara nga vetë njeriu, edukimi i komunitetit mund të ndihmojë që të menaxhojmë këto rreziqe dhe të parandalojmë që këto ngjarje të shndërrohen në katastrofa. *Emergjencat në ambient shpesh janë një efekt ose pasojë e një krize tjetër emergjente ose humanitare. Prandaj, reagimi ndaj emergjencave mjedisore duhet të koordinohet me katastrofën e përgjithshme dhe reagimin humanitar, duke përdorur strukturat ekzistuese kombëtare dhe lokale të koordinimit*<sup>133</sup>.

Ndryshimet klimatike kanë një efekt të pashembullt në shfaqjen e katastrofave natyrore dhe rrezikun që përcjellin emergjencat në ambient. Me ndryshimin e klimës që tashmë është duke ndodhur, ngjarjet e ardhshme emergjente të lidhura me klimën do të gjenerojnë kërkesa të shtuara dhe më të kushtueshme për parandalimin e emergjencave.

Rreziqet për mjedisin si dhe për shëndetin e njeriut nga ekspozimi ndaj agjentëve dhe shkaktarëve të sëmundjeve të ndryshme janë të lidhura ngushtë me katastrofat dhe emergjencat në mënyra të ndryshme. Përmes arsimit dhe edukimit më të mirë, rritet aftësia e njerëzve për t'u përballur me rreziqet që po i kanosen mjedisit<sup>134</sup>. Në nivel global, numri i fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga njeriu, që nga vitet 1980 është dyfishuar si p.sh.:

Më shumë se 680,000 njerëz vdiqën nga tërmetet në periudhën ndërmjet viteve 2000 dhe 2010, kryesisht për shkak të ndërtimeve jo të sigurta.

Çdo vit, një mesatare prej 102 milion njerëzish në mbarë botën preken nga përmbytjet, 37 milionë njerëz nga ciklonet, uraganet dhe tajfunet, dhe gati 366,000 njerëz nga rrëshqitjet e tokës.

Pjesa më e madhe e popullsisë botërore jetojnë pranë brigjeve të lumenjve, në brigjet e ekspozuara të deteve dhe në qytetet e vendosura në zonat me aktivitet të lartë sizmik.

Ndryshimet e klimës rrisin rrezikun për reshje të shumta, të cilat mund të shkaktojnë përmbytje dhe rrëshqitje të tokës. Këto ndryshime mund të çojnë në erëra të forta, dhe në shumë rajone shkaktojnë valë të nxehtit dhe thatësira. Rritja e nivelit të detit kërcënon të gjitha zonat e ulëta bregdetare në botë<sup>135</sup>.

## 2. EMERGJENCAT NË AMBIENT PËR SHKAK TË NDOTJES SË AJRIT

Ndotja e ajrit në Republikën e Kosovës paraqet një problem emergjent mjedisor dhe sidomos nëpër viset urbane dhe industriale. Cilësia e ajrit është veçanërisht e ulët në zonën e Prishtinës, Obiliqit, Hanit të Elezit, Drenasit si dhe të Mitrovicës. Burimet kryesore të kontaminimit janë dyoksidi i sulfurit (SO<sub>2</sub>), oksidet e azotit NO dhe NO<sub>2</sub> (NO<sub>x</sub>), ozoni (O<sub>3</sub>), plumbi (Pb), dyoksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>), grimcat (PM apo pluhuri) dhe dyoksina<sup>136</sup>. Burimet kryesore janë:

Prodhimi i energjisë dhe minierat, përfshirë dy termocentralet me thëngjill të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe sipërfaqja e saj për nxjerrjen e thëngjillit, druri dhe linjiti për ngrohje të shtëpive, komplekset industriale, siç janë Parku industrial i Mitrovicës (Trepçë), miniera dhe prodhimi i nikelit në Drenas (Ferronikeli), dhe fabrika e çimentos në Hanin e Elezit (Sharrem) etj., kompanitë e ngrohjes qendrore (në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë), transporti, deponitë e mbeturinave urbane dhe industriale (me ndikim të ndryshëm lokal).

Termocentralet e KEK-ut (Kosova A dhe B në Obiliq) janë burimet kryesore të ndotjes së ajrit, edhe pse emetimet e NO<sub>x</sub> janë në nivel të barabartë në mes të termocentraleve, transportit dhe industrive të tjera. Emetimet në ajër nga centralet janë të rëndësishme për ndotjen e ajrit në Prishtinë dhe në komunat rreth saj. Pastaj ndezja e linjtit dhe druve për ngrohje të shtëpive shkaktojnë emetime substanciale të grimcave duke mos përjashtuar edhe gazrat e liruar nga më se 400.000 vetura. Niveli i emetimeve në ajër nga termocentralet është shumë më i lartë sesa që lejohet me Direktivën e Komisionit Evropian (KE) për impiantet me ndezje të madhe (Tabela 2.1), përmes emetimeve të grimcave të ngurta nga Kosova B paraqesin faktorin 3-6 herë më të ulët sesa nga Kosova A. Megjithatë, filtrat elektrostatikë për largimin 90% të grimcave nga oxhaqet janë instaluar që nga viti 2012 në Kosovën A.

<sup>133</sup> John R. Labadie, Ph.D., "Environmental management and emergency management in post-disaster reconstruction"

<sup>134</sup> B. Wisner, J. Adams, Environmental health in emergencies and disasters

<sup>135</sup> UNESCO and UNICEF, 2014, Towards a learning culture on safety and resilience: Technical guidance for integrating DRR into the school curriculum, GENEVA, UNICEF

<sup>136</sup> Luzha, I, 2014, Air pollution in Hani Elezi from emissions of CO<sub>2</sub> and SO<sub>2</sub> through Cement Factory, XX Congress of the Carpathian Balkan Geological Association, Tirana, Albania, 24-26 September, p. 343.

Tabela 1. Emetimet në ajër gjatë vitit 2010 (mg/Nm<sup>3</sup>)<sup>137</sup>

Termocentrali	Kosova A			Kosova B		Vlera e lejuar, 2001/800/EC
	Blloku	A3	A4	A5	B1	
SO <sub>2</sub>	685	652	829	629	878	400
NO <sub>2</sub>	694	700	692	810	811	500
Pluhur/grimca	1535	1850	1401	240	428	50

Shënim: Nm<sup>3</sup> është metër normal kub

Monitorimi i cilësisë së ajrit, që është në shkallë të kufizuar në Kosovë, kryhet nga Instituti hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) që menaxhon me vetëm dy stacione monitorimi. Njëri gjendet afër ndërtesës së ish Rilindjes në qendër të Prishtinës, afër rrugës me qarkullim të dendur, dhe është i konfiguruar për të matur vetëm fraksionet e grimcave PM10 (dhjetë mikronë), PM2.5 (dy mikronë e gjysmë), dhe PM1 (një mikron), ndërsa tjetri është stacion në periferi në objektin e IHMK-së, i pajisur me analizues automatik për dyoksid të sulfurit, okside të azotit, monoksid të karbonit, ozon dhe grimca të imta (PM10 dhe PM2.5). Stacionet tjera të monitorimit janë instaluar nga Instituti i Shëndetit Publik, por nuk funksionojnë. Kompanitë që kanë ndikim negativ në cilësinë e ajrit (KEK, Sharrcem dhe Ferronikeli) obligohen që të monitorojnë emetimet në ajër nga puna e tyre dhe t'i dorëzojnë raportet e monitorimit te Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM), por këto informata nuk janë publike. Të dhënat për cilësinë e ajrit nga IHMK tregojnë se këto grimca mikronëshe tejkalojnë dukshëm kufirin nga vlerat e lejuara sipas legjislacionit në fuqi për përqendrimin mesatar vjetor prej 40 mikrogramëve për metër kub (µg/m<sup>3</sup>) për PM10, si në qendër të qytetit (ndërtesa e Rilindjes) ashtu edhe në periferi (në stacionin e IHMK), dhe shpeshherë tejkalon vlerën kufitare ditore (që nuk duhet të tejkalohej më shumë se 35 herë në vit) prej 50 µg/m<sup>3</sup> (shih tabelën 2.).

Tabela 2. Vlera mesatare mujore e përqendrimit të PM10 dhe PM2.5, 2010 dhe 2011 (µg/m<sup>3</sup>)<sup>138</sup>

Muaji	PM10				PM2.5	
	Ndërtesa Rilindja, 2010	Ndërtesa Rilindja, 2011	Stacioni IHMK 2010	Stacioni IHMK 2011	Ndërtesa Rilindja, 2010	Ndërtesa Rilindja, 2011
Janar		129.59	72.3			106.62
Shkurt		106.48	-			75.25
Mars		76.18	44.5	56.0		45.9
Prill		55.83	37.2	45.2		26.72
Maj		41.94	36.2	37.2		20.83
Qershor	53.56		43.3		14.33	
Korrik	57.14		47.1		19.92	
Gusht	68.09		44.9		19.61	
Shtator	52.22		40.5		20.55	
Tetor	65.48		42.7		34.26	
Nëntor	105.01		78.8		51.36	
Dhjetor	128.73					

Shënim: Vlera mesatare e lejuar vjetore është 40 µg/m<sup>3</sup>

Efektet kryesore të këtyre grimcave në ajër në shëndetin publik janë sëmundjet respiratore dhe efektet kardiovaskulare. Efektet që i atribuohen ekspozimit afatgjatë përfshijnë mortalitetin për shkak të sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore, sëmundjeve kronike respiratore (astma, sëmundjet kronike të mushkërive, dhe ndryshimet kronike patologjike), kanceri i mushkërive, sëmundjet kronike kardiovaskulare, dhe pengesat në rritjen intrauterine (për shembull pesha e ulët në lindjen normale etj.). PM2.5 rritë nivelin e mortalitetit për shkak të kancerit kardiopulmonar dhe të mushkërive, dhe PM10 rritë morbiditetin kryesisht për shkak të bronkitit kronik, sëmundjeve të traktit të poshtëm respirator te fëmijët dhe simptomave të traktit respirator. Të dhënat nga IHMK

<sup>137</sup> KEK 2010

<sup>138</sup> Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, Raporti për vitin 2011

rreth cilësisë së ajrit tregojnë se përqendrimet e PM në Prishtinë tejkalojnë vlerat kufitare të lejuara. Tabela gjithashtu tregon se gjatë dimrit nivelet e ambientit të PM10 dhe PM2.5 janë shumë më të larta sesa në periudhat tjera të vitit. Kjo për shkak të linjitet të shfrytëzuar nga termocentralet në Obiliq dhe nga shtëpitë që djegin dru dhe thëngjill për ngrohje si dhe për shkak të mikroklimave të qytetit të Prishtinës. Në mungesë të të dhënave për cilësinë e ajrit nga qytetet tjera në Kosovë, supozohet se mesatarja vjetore urbane e Prishtinës (78 µg/m<sup>3</sup> të PM10 dhe 40 µg/m<sup>3</sup> të PM2.5) vlen si vlerë e ekspozimit për shumicën e banorëve në qytetet e mëdha, dhe se mesatarja në qytetet mesatare dhe të vogla është më e ulët, PM10 = 60 µg/m<sup>3</sup> dhe PM2.5 = 30 µg/m<sup>3</sup> (d.m.th. pak më e lartë sesa në periferi të Prishtinës). Dyoksidi karbonit dhe substancat e tjera me potencial për ngrohje globale nuk dëmtojnë drejtpërdrejtë shëndetin apo mjedisin, por efektet vërehen përmes ngrohjes globale dhe atë:

- Ngritja e temperaturave dhe e nivelit të reshjeve.
- Mungesa e ujit dhe ndryshimet në hidrologji.
- Ngritjet në nivelin e detit etj.

### 3. EMERGJENCAT NË AMBIENT PËR SHKAK TË NDOTJES SË UJËRAVE

Ndotja e ujërave në Kosovë kryesisht buron nga kontaminimi bakteriologjik si rezultat i mungesës së impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, mirëpo edhe për shkak të aktiviteteve industriale dhe për shkak të mostrajimit të tyre para hedhjes në recipient. Njëzetedy stacione hidrometrike që funksionojnë në kuadër të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës monitorojnë cilësinë e ujit sipërfaqësor. Nuk ekziston monitorimi i ujit nëntokësor apo monitorimi i ujërave të zeza urbane. Cilësia e ujit të pijshëm monitorohet nga Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës. Të dhënat nga monitorimi tregojnë se ndotja e ujit të pijshëm është më i lartë nga kontaminimi bakteriologjik sesa nga kontaminimi kimik<sup>139</sup>.

Tabela 3. Rezultatet e analizave mikrobiologjike të ujit të liqenit të Badovcit

Numri i mostrave	Psihofile 22°C në 1ml	Mesofile 37°C në 1ml	Numri total Coliforme në 100ml	Lloji i bakteve të identifikuara	Cl perf në 100ml	F Strepto- kokus	F Koliforme në 44°C
438	4x10 <sup>3</sup> - 8x10 <sup>3</sup> (4100- 8000 Koloni)	1x10 <sup>3</sup> - 5x10 <sup>3</sup> (100-500 Koloni)	32 mostra ose (7.30% prej mostrave)	E.coli, SerratiasppKlebsiella spp. Aerom. HydrophillaAerom.sobria, Hafnia Alvei.AcinetobacterCitrobacter , Providentia, Pantoea.Sfingomon paucimobilis	9 Mostra ose (2.05% prej mostrave)	11 Mostra ose (2.51% prej mostrave)	51 Mostra ose (11.64% prej mostrave)
Vlera maksimale		300cfu/ml	100cfu/100 ml		10cfu	0	0

Shumica e bakteve janë në sistemet e ujës-jellës nëpër qytetet e vogla dhe viset rurale ku 74-90% e puseve dhe burimeve përmbajnë kontaminime fekale dhe të ujërave të zeza (AKMM 2010). Sa i përket cilësisë sanitare biologjike të ujit, lumenjtë janë klasifikuar si të ndotur dhe kanë nivele të papranueshme të kërkesës për oksigjen biologjik, si dhe mungesë të oksigjenit të tretur nëpër lumenj, në veçanti në përroskat e vogla dhe në rrjedhjet e kanalizimit të pa trajtuara, tabela 4. Ndotësit më të mëdhenj industrial janë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Ferronikeli, Sharrceci, Trepça, Kishnica, Artana dhe minierat e tjera si dhe disa impiante dhe fabrika të ndërtuara pas vitit 1999.

<sup>139</sup> Luzha, I, Spahiu, S, Shabani, M, November 2018 – January 2019, Vol. 9, Water Quality of Lake Badovc by Some Microbiological and Physico-Chemical Parameters, An International Peer Review E-3 Journal of Sciences, Available online at [www.jcbps.org](http://www.jcbps.org), JCBPS; Section D; No. 1; 106-116. E- ISSN: 2249 –1929, [DOI: 10.24214/jcbps.D.9.1.10616], CODEN (USA): JCBPAT, Impact Factor: 1.457(2017-2018).

Tabela 4. Cilësia e ujërave sipërfaqësore, nga lumenjtë në Kosovë<sup>140</sup>.

Sasia (mg/l)	Drini i bardhë	Ibri	Lepenci	Morava e Binçës	Cilësia e ujit
Kërkesa biokimike për oksigjen, më e larta	6.74 (2007)	19.8 (2007)	15.67 (2007)	6 (2007)	Lumenjtë e pastër <1 mg/l
	7.22 (2008)	18.43(2008)	11.97 (2008)	5 (2008)	Mesatarisht të ndotur 2-8 mg/l
	7.22 (2009)	15.1 (2009)	6.8 (2009)	5 (2009)	Kanalizim komunal 20 mg/l
Oksigjeni i tretur, vlera më e ulët e regjistruar	6.6 (2007)	4.2 (2007)	6.1 (2007)	5.8 (2007)	Pa jetë 0-0.2 mg/l
	5.8 (2008)	2.2 (2008)	6.0 (2008)	6.0 (2008)	aerobike
	5.7 (2009)	1.8 (2009)	7.0 (2009)	7.0 (2009)	Problematika me jetën aerobike 0.2-6 mg/l
Kadmiumi	0.01	0.02	0.01	0.01	Koncentrimi maksimal i lejuar: 0.00045 mg/l
Plumbi	0.1	0.1	0.07	0.07	0.072 mg/l, mesatarja vjetore
Nikeli	0.9	0.2	0.2	0.2	0.02 mesatarja vjetore

#### 4. EMERGJENCAT MJEDISORE PËR SHKAK TË NDOTJES SË DHEUT

Toka edhe pse vlerësohet pasuri vitale e çdo vendi, kujdesi dhe sjellja e shoqërisë tonë ndaj tokës dhe mjedisit, vazhdon të mos jetë në nivelin e duhur. Në përgjithësi në gjithë vendin përkundër progresit të arritur nga institucionet qendrore dhe lokale, akoma vërehen dukuri negative si; pyje të prera dhe që prehen, pyje të djegura, erozion dhe degradim të lumenjve nga shfrytëzimi pa kriter, degradim të peizazheve natyror, humbje të burimeve tokësore dhe ndryshim të destinimit të tokës nga ndërtimet kaotike urbane dhe rurale, përmbytjet dhe vërshimet etj. Mijëra hektarë tokë bujqësore vlerësohet së janë zënë me ndërtime nga urbanizmi kaotik urban dhe rural. Të gjitha këto dukuri negative janë vetëm njëra ndër faktorët që po ndikon në degradimin e tokës në vend. Industria, bujqësia, mbeturinat, transporti, dhe ujërat e përdorura janë një ndër ndotësit kryesore të ndotjes së tokave në Kosovë. Shumë vende përreth industrive të renda, si Obiliq, Mitrovicë, Drenas, Han të Elezit, ndotja e tokës vlerësohet se është mjaftë e evidentet. Shqetësimi edhe me i madhe është se këto industri janë në funksion me vite të tëra. Industritë e renda bëjnë shkarkimin e ndotësve në mjedis, çka ndikon edhe në ndotjen e tokës nga prania e mbetjeve të rrezikshme qoftë të metaleve të renda apo kemikateve tjera.

Ky trend i ndotjes dhe degradimit të tokës akoma është në rritje, përkundër shumë masave të ndërmarra nga institucionet lokale dhe qendrore. Pothuajse prej vitit 2000 e deri me sot tokat po shpërdorohen dhe mjedisi vazhdon të degradohet sidomos përgjatë rrugëve kryesore lokale dhe regjionale të Kosovës. Komunikimi jo i mirëfilltë ndërmjet komunitetit, institucioneve lokale dhe qendrore, ka rezultuar me mungesë të të dhënave për numrin e ndërtimeve pa leje në tokat bujqësore, meqë komunat nuk dërgojnë të dhënat të sakta apo jo të plota në Ministrinë e Bujqësisë, pavarësisht se ato janë të obliguara me ligj (Ligji për tokat bujqësore, Nr. 02/L-26), që të raportojnë për degradimin e tokës bujqësore. Sipas vlerësimeve të zyrtareve të MBPZHR, për çdo vit i ndërrohet destinimi i tokave bujqësore 400-500 ha<sup>141</sup>. Në bazë të vlerësimeve kolaudojmë se degradimi i tokave është si rezultat i disa faktorëve specifik, si<sup>142</sup>: Mungesa e zbatimit të ligjeve për token dhe tjera; Ndotja dhe degradimi i mjedisit; Ndotja e burimeve ujore dhe tokave për shkak të menaxhimit të dobët të mbeturinave urbane, industriale, kafshëve dhe mungesës së objekteve të trajtimit të ujërave përdorura; Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore dhe i hapësirës; Tipi i shpërndarë dhe pa planë i vendbanimeve; Ndërtimet e shumta ilegale; Mungesa e sistemit informative për tokat; Mungesa financiare dhe teknike për përmirësim të tokave; Eksplozimi i urban i popullatës; Menaxhim i ultë i tokave nga komunat; Mungesa në informimin e komunitetit për menaxhim të pronës private; Mungesa e infrastrukturës në nivele lokale; Mungesa e përvojës në hartimin dhe zbatimin e politikave për menaxhim të tokave; Mungesa e statistikave gjithëpërfshirëse për menaxhim të tokave etj.

<sup>140</sup> Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, raport vjetor (2010)

<sup>141</sup> Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2016, Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës

<sup>142</sup> Luzha, I, Praktika Planifikuese në Emergjencë, 2018, Kolegji Biznesi, Prishtinë

Tabela 5. Mostra të dheut të analizuara nëpër Komunat<sup>143</sup>

Komunat, emri	Toka bujqësore/ha	Mostra/ha	Analiza e metaleve të rënda	Analiza e parametrave të fertilitetit të tokës	Mostra të bimëve, analiza e metaleve të rënda	Analiza e ndotësve organikë në tokë
Drenas	12,550.00	5050	249	249	15	7
Ferizaj	12,704.0	100	155	155	10	9
F.Kosovë	3,807.00	501	76	76	8	7
Gjilan	12,055.00	100	114	114	10	11
Leposaviq	20,800.00	50	242	242	10	12
Lipjan	12,910.00	50	260	260	7	12
Malishevë	16,069.24	100	157	157	8	7
Mitrovicë	14,954.00	50	166	166	10	10
Novobërd	4,207.00	100	50	50	6	5
Podujevë	18,827.00	100	208	208	7	8
Prishtinë	12,286.00	50	243	243	8	12
Prizren	15,429.70	100	148	148	8	10
Rahovec	13,662.94	100	158	158	8	10
Shtime	3,830.00	100	53	53	7	5
Suharekë	6,764.14	50	200	200	10	7
Vushtrri	12,263.00	50	283	283	10	8
Z.Potok	21.63.00	100	42	42	8	5
Total	214,749	2804	2804	2804	150	145

## 5. PËRFUNDIMI

Emergjencat në ambient dhe ndotjet mjedisore shpeshherë paraqesin rrezik për mortalitetin e hershëm, sikurse edhe shumë faktorë tjerë që rrezikojnë shëndetin publik. Cila është kostoja e shpenzimeve nga institucionet përgjegjëse për të reduktuar këto rreziqe, në krahasim me shpenzimet në sektorët tjerë siç janë arsimit dhe infrastruktura etj. Thënë me fjalë tjera, sa duhet shoqëria të shpenzojë për të shmangur pasojat e emergjencave në ambient dhe mortalitetin e hershëm të popullsisë?

Kostoja e degradimit të mjedisit shpeshherë lihet jashtë vendimmarrjes për shkak të mungesës së informatave rreth shumës së këtyre kostove dhe mungesës së çmimit të tregut. Pasi që kufizimet e të dhënave paraqesin pengesë, ekzistojnë disa fusha mjedisore për të cilat edhe nuk ka përllogaritje. Megjithatë kostoja totale e degradimit jep një përllogaritje të pranueshme të kostos së emergjencave në mjedis, pasi që shumë studime kanë treguar se kostot e degradimit mjedisor shpesh herë janë më të mëdha në krahasim me Bruto Produktin Vendor.

Pasi që Kosova duhet të përafrohet me direktivat e Komisionit Evropian, dhe burimet publike për projektet mjedisore ka gjasë që të kufizohen në afat të mesëm, shteti ynë duhet të kërkojë përkrahje nga donatorët e ndryshëm për të përmbushur kërkesat nga direktivat të cilat kërkojnë investime të mëdha. Duhet shqyrtuar mundësinë e hartimit të planit strategjik për ujësjellës, kanalizim dhe trajtim të ujërave të zeza, përfshirë planin menaxhues për pellgjet kryesore të lumenjve. Ai do të duhej të përfshinë një analizë për kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes dhe duhet të merr parasysh pengesat financiare që kanë të bëjnë me rritjen e tarifave për shërbime komunale me qëllim të arritjes së qëndrueshmërisë afatgjate financiare të investimeve të propozuara. Për shkak të pozitës së Kosovës, si rrafshnaltë në rajon, të gjitha rrjedhjet e ujërave dalin jashtë Kosovës dhe e vetmja mënyrë për të siguruar rezerva ujore është rregullimi i sistemeve ujore si ishte paraparë sistemi Ibër-Lepenc dhe sisteme tjera. Gjithashtu duhet të investojmë në pastrimin e ujërave pasi që shtetet që na rrethojnë mundë të na gjobisin me dënime të rënda për shkak të ujërave të ndotur që derdhen në pellgjet ujore të shteteve që na rrethojnë dhe këto masa mundë ti quajmë me plotë gojën emergjenca në mjedisin e Kosovës.

## REFERENCAT

Bell, J, D, Johnson, J, E, and Hobday, A, J, (2011), *Vulnerability of tropical Pacific fisheries and aquaculture to climate change*, Secretariat of the Pacific Community, Noumea, New Caledonia.  
*Environment and Emergencies*, Forum 26-28 September 2017 (Nairobi, Kenya)

<sup>143</sup> Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2015, Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës

- Guidelines for environmental emergencies*, 2009/17, United Nations, Geneva — GE.09-01522 — November 2009 — 500 — OCHA/ESB.
- ISO 14001:2015, *Environmental management systems*
- Labadie, J. R., (2005), *Environmental management and emergency management in post-disaster reconstruction*, USA.
- Luzha, I., (2018) *Praktika Planifikuese në Emergjenca*, Kolegji Biznesi, Prishtinë.
- Luzha, I., (2015), *Ndikimi mjedisor i aktiviteteve mineral nxjerrës dhe përpunues në rajonin e Kosovës Jug-Lindore*-disertacion, Tiranë.
- Lama, K., (2013) *Menaxhimi i emergjencave*, Kolegji Biznesi, Prishtinë.
- Luzha, I., (2015), *Pollution of water of River Lepenci from Lime Factory in Kaçanik to the border with Macedonia in Hani Elezit*, *Anglisticum Journal (IJLLIS)*,: Volume 4, Issue 2, 2015, e-ISSN: 1857-1878, p-ISSN: 1857-8179, p. 187 – 195.
- Luzha, I., (2014), *Contamination of Soil Under the Influence of Extraction and Processing Industry in South-Eastern Kosovo*, Volume 3, combined issues 8,9,10,11 and 12, e-ISSN: 1857-1878, p-ISSN: 1857-8179, *Anglisticum Journal (IJLLIS)* p. 275-278.
- Luzha, I., (2014), *Air pollution in Hani Elezi from emissions of CO2 and SO2 through Cement Factory*, XX Cngress of the Carpathian Balkan Geological Association, Tirana, Albania, 24-26 September, p. 343.
- Luzha, I., Gjani, E., Kuqaj, S., Bublaku, S., (2014), *Influence of industrial waters of plant Silcapor and river Nerodime in physic-chemicals characteristics of River Lepenci in Kosovo*, 2<sup>nd</sup> International Conference “Water resources and wetlands”, Tulcea (Romania), p. 73-78.
- Luzha, I., Spahiu, S., Shabani, M., (2019) , *Water Quality of Lake Badovc by Some Microbiological and Physico-Chemical Parameters*, An International Peer Review E-3 Journal of Sciences, Available online at [www.jcbps.org](http://www.jcbps.org) , JCBPS; Section D; Vol. 9, No. 1; 106-116. E- ISSN: 2249 –1929, [DOI: 10.24214/jcbps.D.9.1.106116], CODEN (USA): JCBPAT, Impact Factor: 1.457(2017-2018).
- Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2015*, Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës.
- Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2016*, Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës.
- Paeger, J., (2010) *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*, 2010.
- UNESCO and UNICEF, (2014), *Towards a learning culture on safety and resilience: Technical guidance for integrating DRR into the school curriculum*, GENEVA, UNICEF.
- Wisner, B, Adams, J, (2002), *Environmental health in emergencies and disasters*, World Health Organization. [https://en.wikipedia.org/wiki/Environmental\\_emergency](https://en.wikipedia.org/wiki/Environmental_emergency).